



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**



Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_. 2020

**NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE**

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor shpall vend të lirë pune për:

- **1 (një) Specialist Ekonomist në Sektorin e Kujdesit Shëndetësor Parësor dhe Spitalor pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Korçë.**

Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Korçë janë:

- Të jetë shtetas Shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbush kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces në prokurori apo gjykatë;
- Të mos jetë pushuar më parë nga administrata e FSDKSH-së apo shërbimi Civil për thyerje të disiplinës a shkelje të tjera serioze;
- Të ketë diplomë në Fushën e Ekonomisë;
- Të jetë i komunikueshëm dhe të ketë aftësi të punës në grup;
- Zotërimi i gjuhëve të huaja do të jetë avantazh (preferohet anglisht);
- Të zotërojë kompjuterin;
- Aftësi komunikuese dhe pune në grup;
- Nota mesatare do të jetë avantazh.

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentat pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Korçë , **brenda datës 15.12.2020**, këto dokumenta;

- Kërkesë me shkrim për tu punësuar;
- Jetëshkrimi i plotësuar ( CV)
- Diplomë e noterizuar ( për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njëhësi nga Ministria e Arsimit);
- Diplomë Master e noterizuar;
- Listë notash e noterizuar;
- Dëshmi për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
- Çertifikatë familjare;
- Çertifikatë kompjuteri;
- Referencë pune nga vendi ose vendet e punës ku ka punuar;

- Librezën e punës (fotokopje) ;
- Kartë identiteti (fotokopje) ;
- Dëshmi penaliteti ( të datojë brenda 3 muajve të fundit);
- Raport mjekësor për aftësi në punë.

**Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentat të dorëzohen në zarf të mbyllur, i cili protokollohet pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Korçë.**

**Adresa: Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Korçë, Rr. 1 Maji, Lagjia 9, tel/fax: +355 82 42706.**